# TRIBUNA SINDIKALE

**Nëntor 2006**

Dhe drit’ e diturisë
përpara do na shpjerë






Editorial

# PROGRAM KONKRET VEPRIMI PER ELIMINIMIN E PUNES SE FEMIJEVE

Konferenca "Sindikatat shqiptare te arsimit kunder punes se femijeve" nuk ishte vetem nje bilanc i punes se kryer ne keto kater-pese vitet e fundit per mbrojtjen e femijeve dhe luftes kunder formave te keqia te punes se tyre, por ajo u konsiderua si baze per te hartuar nje program te qarte, konkret dhe mobilizues per te ardhmen.

Tashme eshte plotesisht e qarte se angazhimi i FSASH dhe SPASH ne veprimtarite per eliminimin e punes se femijeve dhe kthimin e tyre ne shkolle, per te mundesuar arsimimin e tyre si edhe moshataret e tjere, nuk eshte dicka spontane dhe as nje ceshtje fushate, por nje angazhim i perhershem dhe i vazhdueshem mbi bazen e nje programi konkret.

Ne muajt dhe vitet qe vijne do te zgjerohet harta e rretheve ku do te angazhohen FSASH dhe SPASH per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve, per uljen dhe eliminimin e numrit te nxenesve qe braktisin shkollen ose frekutojne me nderprerje, duke perfshire krahas rretheve te Tiranes, Fierit, Shkodres e Elbasanit edhe rrethet e Durresit dhe Korces, pa lene menjane edhe punen ne rrethe te tjera.

Sindikatat e arsimit do te vazhdojne te veprojne nepermjet grupeve te posacme te punes, atje ku kane ekzistuar dhe te do te ngrene grupe te reja, sidomos ne Durres dhe Korce. Por, me rendesi te vecante eshte fuqizimi i ketyre grupeve, shtrirja ne nivel shkolle dhe terheqja ne to e sa me shume aktoreve, perfshire mesues, nxenes, prinder, perfaqesues te punedhenesit, te organeve te pushtetit vendor, te organeve te rendit dhe organizatave e shoqatave jo fitimprurese etj.

Trajnimi sindikal i drejtuesve te sindikatave, por vecanrisht i mases se sindikalisteve qe merren drejtperdrejt me nxenesit qe braktisin shkollen, qe frekuentojne me nderprerje, etj. perben nje detyre paresore dhe te vazhdueshme. Duke e orientuar trajnimin kryesisht ne baze shkolle, sindikatat do te synojne qe te terheqin ne kete proces edhe prinder e nxenes, nga komunitetet perkatese.

FSASH dhe SPASH do te vazhdojne negocimet me MASH per te krijuar kuadrin e pershtatshem ligjor qe te mundesoje motivimin e mesuesve qe jane angazhuar ne menyre aktive dhe qe arrijne rezultate konkrete me nxenesit qe largohen nga shkolla e punojne ne forma e sektore te ndryshem dhe ne menyre informale.

Po keshtu do te kembengulet qe te zbatohen detyrimet reciproke qe jane perfshire ne Kontraten Kolektive, per t'i pajisur shkollat me vegla muzikore dhe mjedise sportive, me qellim qe te krijohen per te gjithe nxenesit, por vecanrisht per keto kontigjente qe kane pervetesim te dobet, qe frekutojne me hope ose braktisin shkollen, mjedise me terheqese dhe me te ngrohta, qe rrezatojne kulture dhe edukojne me norma te shendosha shoqerore e qytetare.

Tashme sindikatat e arsimit ne vendin tone kane fituar pervoje dhe kane krijuar kapacitetet e nevojshme, qe u mundeson atyre qe te sherbejne si qendra rreth te cilave do te grumbullohen e bashkerendohen veprimtarite e sindikatave te profesioneve te tjera te KSSH e BSPSH per eliminimin e punes se femijeve. Per kete qellim do te ndermerren iniciativa per perfshriejn e perfaqesuesve te tyre ne grupet e punes, sidomos ne nivel qendror e lokale, per organizimin e seminareve e tryezave te rrumbullakta, si edhe per ndermarrjen e veprimeve te perbashketa, sidomos per evidentimin e gjendjes ne ndermarrjet e kompanite perkatese, por edhe per terheqjen e femijeve nga puna ne shkolle.

Lufta kunder punes se paligjeshme te femijeve, objektivi per rikthimin ne shkolle te atyre femijeve qe e kane braktisur ate, eshte nje proces kompleks. Prandaj edhe format e kesaj lufte e veprimtarie kerkohet qe te jene te shumta e te larmishme. Nder keto forma, krahas seminareve, grupeve te punes, fushatave, posterave, publikimit nepermjet medias se shkruar dhe elektronike per te sensibiluar opinionin, thelbesore mbetet puna me secilin nxenes, ndjekja ne proces e tyre, pergjithesimi i arritjeve dhe terheqja e vemendjes ne problemet me te mprehta. Prandaj, ne te ardhmen do te perdoren me me efektivitet tryezat zonale e kombetare, si dhe shkembimi i pervojes e informacionit me sindikatat e arsimit te vendeve te rajonit.

# PERMBAJTJA


- *Editorial:* Program konkret veprimi per eliminimin e punes se femijeve 2
- Nga Fjala Hyrese e z. Xhafer Dobrushi ne Konference 3
- Kronike nga punimet e Konferences Rajonale per eliminimin e punes se femijeve 3
- Konferenca MASH, Durres 12
- Te perkushtuar e optimiste per arritje te reja 12
- Homazh per mesuesin dhe qytetarin e nderuar 12
- Te reja shkencore dhe keshilla praktike 15


***Kopertina e pare:***
*Pamje nga njera prej seancave plenare te Konferences "Sindikatat kunder punes se femijeve"*
***Kopertina e fundit:***
*Pamje nga puna ne grupin mbi legjislacionin ne lidhje me mbrojtjen e femijeve dhe luften kunder punes se tyre*


**TRIBUNA SINDIKALE**
**Nr. 24, Periodike**
*Botim i FSASH dhe SPASH*
*ADRESA: Bulevardi "Zogu i Pare" Pallati Ali Kelmendi, kati III,*
*Tel: 22 83 46*
*Tel & Fax: 25 65 32*
*E-mail:fsash@icc-al.org*
**Keshilli Botues:**
Xhafer Dobrushi,
Bajram Kruja,
Lumturi Mataj,
Defrim Spahiu,
Petref Çelaj,
Aleks Dushi,
Stavri Liko, **Kryeredaktor**

# Konference rajonale mbi rolin e sindikatave kunder punes se femijeve

## Nga Fjala Hyrese e zotit Xhafer Dobrushi

Zoti Minister,
Kolege sindikaliste,
Te nderuar miq e te ftuar,

Konferenca "Sindikatat dhe puna e femijeve", punimet e se ciles po nisim sot, eshte kurorezim i nje pune disa vjecare te te dy sindikatave te arsimit ne Shqiperi: FSASH dhe SPASH. Qellimi i Konferences eshte te bejme nje bilanc te kesaj veprimtarie, fokusuar posacerisht ne objektivat dhe arritjet qe parashikon Projekti " Fuqizimi i Sindikatave te Arsimit ne Shqiperi" per periudhen janar 2005 - dhjetor 2006, qe eshte produkt i nje bashkepunimi te ngushte e cilesor midis dy sindikatave te arsimit ne Shqiperi dhe Konfederates Holandeze te Sindikatave, FNV, dhe Sindikates Holandeze te Arsimit, AOb, qe kane mundesuar mbeshtetjen kryesore financiare dhe trainuese te Projektit. Une shfrytezoj rastin qe t'i falenderoj perzemersisht koleget hollandeze per mbeshtetjen dhe ndihmen e pakursyer qe na kane dhene. Po keshtu, falenderoj perfaqesuesit e ILO- IPEC per kontributin qe kane dhene dhe bashkepunimin me dy sindikatat tona per mbrojtjen e femijeve dhe eliminimin e punes se tyre.

Lufta kunder punes se femijeve, te shkeljes apo mohimit te te drejtave te tyre, ushtrimit te mashtrimit e dhunes mbi ta duke i katandisur ne boten e analfabetve dhe duke i bere viktima te trafikimit apo prostitucionit, duke i denuar qe ta kalojne jeten vetem ne rruge, eshte sot, kudo ne bote, nje problem i madh shoqeror, nje shfaqje e ashper e padrejtesise sociale dhe pabarazise njerezore. Prandaj kjo lufte i perket gjithsecilit. Edhe ne shoqerine shqiptare, ku ky fenomen eshte jo vetem prezent, por edhe kercenues, ka angazhuar ne luften kunder tij dhe duhet te angazhoje me mire ne te ardhmen shtetin, qeverine, punedhenesit, shoqerine civile, prinderit dhe femijet dhe padyshim edhe sindikatat.

Angazhimi i sindikatave te arsimit ne veprimtarite per parandalimin e formave te paligjeshme te punes se femijeve, te pasojave qe rrjedhin nga ky fenomen, sic jane braktisja e shkolles ose frekuentimi me nderprerje qe favorizon e nxit braktisjen, punet e rruges, punesimi informal ne sektore te veshtire si ndertimi, bujqesia apo sherbimet, detyrimi i femijeve per te bere rolin e




Vijon në faqen 3

## Kronike nga punimet e Konferences

Ne vijim te aktiviteteve per zbatimin e Projektit qe kane me kane me sindikatat holandeze AOb e FNV, dy sindikatat shqiptare te arsimit, FSASH e SPASH, ne bashkepunim edhe me Programin Nderkombetar per Eliminimin e Punes se Femijeve te Zyres Nderkombetare te Punes, ILO-IPEC, organizuan ne Tirane, nje konference dyditore rajonale mbi rolin e sindikatave per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve.

Me shume se 60 pjesemarres, perfaqesues te sindikatave te arsimit nga Shqiperia dhe vendet e rajonit u mblodhen ne kete Konference per te diskutuar e percaktuar detyra per zgjerimin e angazhimit te tyre per eliminimin progresiv te punes se femijeve.

Ne punimet e kesaj Konference moren pjese edhe Ministri i Arsimit dhe Shkences, Z. Genc Pollo, nje delegacion i Konfederates Holandeze te Sindikatave, FNV dhe Sindikates Holandeze te Arsimit, AOb, i kryesuar nga Z. Leo Mesman, Zv/ Drejtori i Programit Nderkombetar per Eliminimin e Punes se Femijeve Z. Geir Myrstad, Presidenti i BSPSH, Z. Gezim Kalaja.

Ne punimet e

Vijon në faqen 7

Vijon nga faqja 3

lypesit e deri te format me te renda kriminale si shitja e narkotikeve, trafikimi i organeve ose edhe i vete femijeve, eshte nje mision qe rrjedh nga vete natyra e sindikatave si partnere sociale, nga masiviteti dhe cilesia e anetaresise qe ato perfaqesojne dhe nga kapacitetet qe posedojne.

Kjo do te thote se te dy sindikatat e arsimit nuk jane perfshire rastesisht ne kete veprimtari. Nuk eshte e rastit edhe koha kur ato kane filluar te perfshijne ne problematiken e tyre aktivitetet per mbrojtjen e femijeve dhe parandalimin e atyre puneve qe jane te ndaluara per kete moshe, sepse demtojne shendetin dhe personalitetin e tyre.

Ne fillim te viteve 90-te, kur daton edhe vete krijimi i sindikatave tona, per afro dhjete vjet rresht, nuk ekzistonin kushte qe sindikatat e arsimit te perballeshin njeheresh, si me mbrojtjen sociale ekonomike te mesuesve dhe punonjesve te arsimit e shkences, ashtu edhe me problemet sociale, shkencore e pedagogjike te vete shkolles, me procesin e reformimit dhe modernizimit te saj.

Kerkohej nje periudhe dhe nje proces konsolidimi e pjekjeje te vete sindikatave, nje kapercim i fazes se tyre fillestare, qe te behej i mundur krijimi i nje vizioni me te gjere per objektivat, pergjegjesite dhe veprimtarine e sindikatave si partnere sociale ne fushen e arsimit dhe te arsimimit te brezit te ri, nje vizion qe i shikon te pandara kerkesat dhe objektivat sociale ekonomike per mbrojtjen e anetareve me kerkesat per mbrotjen, reformimin dhe modernizimin e shkolles, ne kuptimin e gjere te kesaj fjale.

Pikerisht ne kete etape, ne fillim te viteve 2000, paralelisht me angazhimin me efektiv te te dy sindikatave te arsimit ne procesin e reformimit dhe modernizimit te arsimit, fillojne e ndjehen dhe gjallerohen edhe veprimet e para sindikale per mbrojtjen e femijeve dhe behet nje pune me e programuar kunder formave te demshme e te paligjeshme te punes se tyre. Ketu ze fill edhe bashkepunimi me Zyren e Programit Nderkombetar per Eliminimin e Punes se femijeve ne Tirane, bashkepunim qe vazhdon edhe sot.

Si hap i pare, ne kuadrin e ketij bashkepunimi, gjate vitit 2002, u ndermore trainimi i nje grupi prej rreth 20 veprimtaresh e drejtuesish sindikale mbi bazen e Konventave Nderkombetare te Punes qe trajtojne kete ceshtje, te Kodit te Punes dhe te akteve nenligjore te qeverise shqiptare, dhe u vazhdua me aktivitete e seminare zonale ne rrethet Tirane, Vlore e Pogradec, ku u trajnuan rreth 70 mesues e drejtues sindikaliste nga keto zona dhe u ndermoren veprime konkrete per permiresimin e gjendjes, sidomos ne shkollat e pjesemarresve ne keto trajnime.

Ipec ka patur dhe ka ndikim edhe ne perfshirjen e sindikatave tona ne aktivitete te perbashketa te organizatave e shoqatave qe jane te angazhuara ne kete fushe, ne propagandimin dhe perhapjen e paketes SCREAM, etj.

Paralelisht me keto veprimtari dhe mbi bazen e arritjeve ne proces, qe nga viti 2002, me ndermjetesimin e Federates Boterore te Arsimit, EI, filloi bashkpeunimi me Sindikaten e Arsimit te Holandes, AOb, me Fondacionin NOVIB dhe, me pas, me Konfederaten Holadeze te Sindikatave FNV.

Qe ne etapat e para te ketij bashkepunimi, duke u ballafaquar me permasat e problemit te punes se femijeve, kur perafersisht cdo vit numri i atyre qe braktisnin shkollen varionte nga 6000 deri ne 7.000 femije dhe 40.000 deri ne 50000 prej tyre punonin ne rruge ose ne sektore infomal te ekonomise, u arrit ne perfundimin e drejte se suksesi ne kete angazhim mund te arrihej vetem nga sindikata te fuqishme, qe ekzistojne e funksionojne mbi baza statutore, qe mbeshteten ne te gjithe potencialet e tyre te mundeshme dhe qe ndertojne e posedojne kapacitetet e duhura per te perballuar probleme te tilla te veshtira, me interes te madh per shkollen dhe shoqerine, sic eshte mbrojtja e femijeve dhe eliminimi i formave te paligjshme te punes se tyre.

Kjo eshte arsyeja qe permbajtja e Projektit qe u zbatua gjate ketyre dy viteve te fundit, per te cilin po diskutojme sot, ndonese mbeshtetet ne 4 kollona kryesore, ka patur dhe ka si synim paresor fuqizimin e sindikatave te arsimit ne Shqiperi.

Ky fuqizim eshte i lidhur ne menyre te pandare me demokratizimin e jetes dhe veprimtarise se sindikatave, me rritjen e forces bindese dhe argumentuese ne procesin e negocimit e te dialogut social, me organizimin dhe rritjen e rolit te grave e te mesuesve te rinj ne jeten e sindikates, me gjallerimin e formave te punes se saj, me rritjen e inisiatives dhe vetveprimit te sindikatave te bazes ne shkolle dhe ne seksione.

Pervoja e fituar ne keto vite, sic do te kemi rastin ta shikojme me konkretisht gjate gjithe kesaj konference, provon se vetem duke punuar paralelisht ne te gjitha drejtimet qe permenda mundesohet edhe arritja e rezultateve ne rritje edhe ne procesin e punes e te luftes per mbrojtjen e femijeve dhe parandalimin e punes se tyre.

Nje konkluzion tjeter qe ka terhequr vemendjen tone si sindikata dhe qe ka garantuar disa suksese, ndonese modeste eshte se ne kemi synuar dhe synojme qe te krijojme tek te gjithe sindikalistet dhe mesuesit opinionin se lufta per mbrojtjen e femijeve, kunder formave te ndryshme antiligjore te punes se tyre eshte nje problem me te cilin do te ballafaqohemi per nje kohe te gjate dhe se suksesin e ketij angazhimi do ta kemi duke kaluar nga shqyrtimi i fenomenit ne pergjithesi, ne shkalle vendi, ne fokusimin ne qarqe, rrethe e zona te vecanta, atje ku ai eshte me i mprehte dhe me shqetsues. Per kete arsye, ne, gjate dy viteve te fundit u perqendruam ne 4 rrethe me problematike, sic jane Tirana, ( kryesisht zona e Kamzes), Shkodra, Fieri dhe Elbasani.

Edhe brenda ketyre qarqeve apo rretheve, ka shkolla ose zona, ku fenomeni i braktisjes se shkolles dhe i punes se femijeve eshte shume i perhapur, ndersa ne shkolla te tjera problemi ose eshte i paperfillshem ose nuk ekziston fare. Ne tashme kemi ndertuar nje harte ne te kater keto rrethe,

ku evidentohen shkollat ose zonat ,qe sindikatat tona te arsimit do te perqendrohen ne te ardhmen. Objektivi per vitet qe vijne eshte qe sindikatat te ta konkretizojne me tej veprimtarine e tyre per ta bere efektive, duke u marre me klasadhe individe konkrete dhe duke bashkepunuar me mire me komunitetin e prinderve dhe pa dyshim me drejtorite e shkollave.

Ne kemi arritur ne perfundimin se ka qene e efektshme puna qe kemi oganizuar me grupe Pergjegjese ne shkalle kombetare, rrethi ose zone.

Grupet e punes ne cdo rreth kane bere nje pune konkrete per evidentimin e gjendjes, per nxitjen e angazhimit te mesuesve per nje pune te vecante me nxenesit qe e kishin braktisur ose ishin ne rrezik per ta braktisur shkollen, per koordinimin e veprimeve me administratat e shkollve dhe aktoret e tjere ne komunitet, si edhe per pergatitjen e seminareve qe FSASH e SPASH kane organizuar me lektoret e tyre, por ne menyre te vecante me ndihmen e kualifikuar dhe te pakursyer dhe pervojen e pasur te lektoreve holandeze, qe sot i kemi midis nesh. Sindikatat kane treguar kujdes qe pjesemarresit ne seminar te jene drejtues aktiv te keshillave sindikale ne shkolla dhe mesues e mesuese qe jane angazhuar ne punen me femijet qe largohen nga shkolla ose kane tendence per t'u larguar, mesues qe sakrifikojne, qe me figuren e tyre i terheqin nxenesit, qe ne nje fare menyre jane bere prinder te dyte per ta. Disa nga keto mesuese e mesues i kemi sot ne kete konference dhe ata do te kene rastin te flasin vete per punen qe kane bere. Synimi ka qene qe te gjithe keta drejtues dhe mesues sindikaliste pjesemarres ne keto seminare, dhe ne te gjithe veprimtarite e perditshme, jo vetem te japin ndihmesen e tyre ndaj nxenesve me te cilet punojne drejtperdrejt, d.m.th., qe i kane ne klasat ne kujdestari apo ku japin mesim, por edhe te afteschen e pergatiten si lektore, si trajnues, si propagandiste, per dhjetra e qindra mesues te tjere ne shkollat e tyre ose ne shkolla te tjera te zones ku problemi i punes se femijeve dhe braktisjes se shkolles eshte prezent.

Ne kemi qene dhe jemi te ndergjegjshem se trainimi dhe pergatitja serioze e drejtuesve sindikale dhe mesuesve ne seminare dhe forma te tjera pune, se krijimi i nje opinioni te shendoshe dhe sensibilizimi i mases se madhe te sindikalisteve mesues per t'u perfshire te gjithe keta ne frontin e aktoreve te tjere qe luftojne per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve, per mbrojtjen e tyre nga rreziqet qe u kanosen per te perfunduar ne analfabete dhe ne kontigjente te krimit, nuk mund te behet pa u mbeshtetur ne dokumente, ne materiale dhe ne nje kuader ligjor bashkekohor, qe ne teresine e tyre perbejne standardet e sotme europiane e boterore per mbrojtjen e femijeve.



Per te mundesuar venien ne dispozicion te sindikalisteve te ketyre materialeve, per te bere nje trajnim te bazuar, sindikatat e arsimit kane bere nje sere botimesh, sic jane Libri me 52 Konventa Nderkombetare te Punes, broshura " Sindikatat dhe puna e femijeve", revista "Tribuna Sindikale", artikuj te vecante ne media, postera, etj., ku lexuesit mund te njihen me Konventen Nr. 138 " Per moshen minimale" dhe Konventes Nr. 182 "Per format me te keqija te punes se femijeve", me rekomandimet si dhe me kuadrin ligjor shqiptar qe percakton moshen minimale per pune ne Shqiperi, ( shih neni 98 i Kodit te Punes), dhe Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 205 date 20.05.2002 " Moi listen e puneve te veshtira ose te rrezikshme me ekspozim te demshem ndaj agjenteve fizike, biologjike dhe kimike per te miturit nen 16 vjec.

Ne te gjithe debatet qe kemi zhvilluar neper seminare dhe ne ndertimin e programeve per te levizur e permiresuar gjendjen, FSASH dhe SPASH jane ndalur edhe ne disa shkaqe qe ne te ardhmen duhet te na terheqin me shume vemendjen.

Tani e kemi me lehte te themi se shkaqet qe nxitin braktisjen e shkolles dhe punen e femijeve jane varfera, problemet sociale, etj., por pak ose aspak ndalemi ne faktore te tille si cilesia e mesimit qe ofron shkolla, niveli i mesimdhenies nga cdo mesues. Dihet se nxenesit qe frekutojne ne menyre te crregullt shkollen ose e braktisin ate, jane nga ajo kategori femijesh qe kane pervetesim te ulet, qe nuk tregojne shume interes per oren e mesimit, qe me boshlleqet qe kane krijuar e kane te veshtire te ndjekin rrjedhen logjike te oreve te mesimit. Eshte mesuesi ai, qe duke njohur nxenesit qe ka perpara, duhet te beje pergatitje serioze, te perdore metoda aktive e interesante per ta gjalleruar oren e mesimit ne klase, te beje pune te diferencuar jashte klase, te dije te zgjoje tek ky kontigjent femijesh interesin per dije, per kulture, per sjellje, etj. Por sindikatat tona ndalen ende pak ne keto probleme.

Ne veprimtarite qe kemi zhvilluar ne kater rrethet qe permenda jane evidentuar me dhjetra e dhjetra shembuj mesuesish te tille. Por, ka edhe prej atyre qe me zor shtyjne oren e mesimit, qe nuk ngjallin

Vijon në faqen 6

Vijon nga faqja 5

asnje interes, qe jane monotone, qe perserisin ato qe kane thene 10 vjet me pare, etj. Eshte ky nivel i ulet cilesor, qe ne shume raste behet shkak plotesues ne vendimin e femijeve te lekundur per t'i kthyer shpinen shkolles, sepse ne raste te tilla ata edhe ne shkolle nuk gjejne ngrohtesine dhe mbeshtetjen qe u mungon ne jete dhe ne familje.

Prandaj, angazhimi dhe mbeshtetja qe sindikatat i japin reformimit dhe modernizimit te arsimit ndikon direkt edhe ne mbrojtjen e femijeve, ne pakesimin e numrit te nxenesve qe largohen nga shkolla. Sindikatat e kane kete mundesi, sepse ne radhet e tyre militojne mijera mesues dhe edukatore te perkushtuar, qe jane kerkues ndaj vetvetes, por edhe kritike ndaj dobesive, te metave dhe prapambetjes se kolegeve.

Ka edhe nje shqetsim tjeter. Sot, pothuaj ne te gjithe shkollat e vendit, disa lende qe eshte bere zakon te konsiderohen "dytesore", por qe ne te vertete luajne rol vendimtar ne formimin qytetar, kulturor dhe te karakterit te femijte qe jane e ardhmja e shoqerise, sic jane muzika, fizkultura, edukata, etj. behen formalisht, ne shume raste nga mesues jo te profilit, duke krijuar boshlleqe serioze ne formimin e nxenesve.

Tipik eshte rasti me lenden e muzikes dhe te fizkultures. Ne rrethe me tradita te spikatura kulturore e arsimdashese si Shkodra, Korca apo Elbasani, ne shumicen absolute te shkollave te qytetit, pa permendur fshatin, nuk ka nje vegel muzikore, as nje qender zeri. Edhe kur mesimi behet nga mesues te profilit dhe me arsim perkates, ata kane mundesi te kene ne dore vetem shkumesin, me te cilin mund te krijoje melodi duke goditur drrasen e zeze.

Nuk do te ndalemi ketu per te bere moral dhe per te kujtuar se muzika eshte nder ato lende qe ndikon drejt per drejt ne krijimin e nje kombi te kulturuar, por per temen qe po diskutojme, zhvillimi i kesaj ore ne nivelin qe kerkohet i terheq edhe nxenesit me te painteresuar per disiplinat e tjera.




Ketu nuk eshte fjala se nuk ka mundesi financiare per te blere keto paisje te thjeshta, me shume eshte neglizhence dhe mungese vleresimi.

Po keshtu ndodh edhe me fizkulturen. Eshte lenda qe terheq me shume dhe u krijon ambjent nxenesve qe ndjekin me veshtiresi lendet e tjera. Por kjo kerkon qe te kete nje baze minimale materiale dhe te ruhen e mirembahen terrenet sportive.

Te dy keto konstatime jane bere nga vete nxenesit qe, mbasi kane braktisur shkollen, ne saje te punes qe eshte bere me ta, jane kthyer, jane pershtatur dhe kane frekuentuar rregullisht.

Keto mungesa materiale bejne qe shkollat te zhvillojne akoma pak veprimtari kulurore, sportive, konkurse, etj., te cilat terheqin masen e madhe te nxenesve dhe u plotesojne ato mangesi qe nuk ua jep jeta jashte shkolles.

Pervoja qe fituam ne keto dy vjet ne takimet me grupet e punes dhe vecanrisht ne debatet aktive qe u zhvilluan ne seminaret me sindikaliste ne rrethet Fier, Shkoder, Elbasan dhe Tirane, nga trajtimi i ketij problemi me veprimtare e sindikaliste te bazes ne rrethet Vlore, Korce, Durres dhe Berat, nga publikimi i ketyre veprimtarive ne revisten « Tribuna Sindikale » krijoi mundesi dhe lehtesi qe diskutimin dhe sensibilizimin e problemit te punes se femijeve ta nxjerrim jashte kuadrit te rretheve qe permendem me siper dhe ta shtrijme pothuaj ne te gjitha seksionet e keshillat sindikale te vendit, ne te cilet, megjithese nuk eshte zhvilluar nje veprimtari sistematike, eshte sensibilizuar opinioni i mesuesve e sindikalisteve dhe kane filluar te duken rezultate konkrete.

Ne kete situate sindikatat tona te arsimit arriten ne perfundimin se ka ardhur koha qe ato te marrin persiper me shume pergjegjesi kontraktuale per mbrojtjen e femijeve dhe parandalimin e punes se tyre dhe, njekohesisht, te kerkojne nga punedhenesi, MASH, bashkepunim e partneritet me efektiv e kontraktual per zgjidhjen e disa kerkesave, qe ndikojne ne zbutjen e fenomenit te braktisjes se shkolles dhe eliminimin e punes se femijeve.

Kjo beri te mundur qe ne Kontraten e re Kolektive te Punes, ceshtja e mbrojtjes se femijeve dhe eliminimit te punes se tyre, ne kuadrin e gjithe reformimit dhe modernizimit te arsimit, te zeje nje vend te vecante.

Keshtu, ne nenin 10 te Kontrates Kolektive te Punes, nder te tjera theksohet se te dy sindikatat e arsimit angazhohen qe te bejne nje pune te vecante per uljen e numrit te nxenesve qe braktisin shkollen dhe te atyre qe punojne ne rruge. Sindikatat kane perfshire ne Kontraten Kolektive detyrimin e tyre qe te punojne per rritjen e numrit te mesuesve qe do te bejne nje pune te vecante me nxenesit qe braktisin shkollen ose qe jane ne rrezik per ta braktisur ate, duke krijuar per ta nje mjedis me te ngrohte, me terheqes e me prinderor, duke mbajtur si objektiv te perhershem e te rendesishem eliminimin

e punes se femijeve.

Po ne kete dispozite te Kontrates Kolektive, Ministria e Arsimit dhe Shkences merr persiper qe te siguroje gatishmerine e administrates se shkollave per veprime te perbashketa, duke nxitur perfshirjen e komunitetit te nxenesve dhe prinderve ne procesin e veprimtarise per mbrojtjen e femijeve dhe duke u paraqitur si pale e perbashket me sindikatat para organeve te pushtetit vendor dhe institucioneve te tjera, qe jane te interesuara ose te ngarkuara me ligj per mbrojtjen e femijeve dhe eliminimin e punes se tyre.

Ne, tashme jemi te bindur se suksesi i angazhimit te sindikatave te arsimit kunder punes se femijeve nuk mund te arrihet pa nje bashkepunim efektiv me organet e pushtetit vendor, qe nga keshillat e qarqeve, prefekturat, bashkite dhe komunat, bashkepunim qe tani i ka hedhur bazat e veta. Po keshtu, ne do te bashkepunojme me te gjithe ata aktore te shoqerise civile qe jane perfshire ne frontin e luftes kunder punes se femijeve.

Sindikatat e arsimit, natyrisht nuk jane te vetme ne veprimtarine e tyre per mbrojtjen e femijeve. Me veprimtarine qe kane zhvilluar deri tani, ato mund dhe do te bejne me shume per te krijuar nje front me te gjere sindikal se bashku me sindikatat e profesioneve te tjera, si ato te bujqesise, ndertimit, shendetsise, sherbimeve publike, tekstilit, etj.

Te nderuar pjesemarres.

Ne kete Konference ne gjykuam te ftojme edhe perfaqesues te sindikatave te arsimit nga rajoni, me te cilat prej shume vitesh kemi marredhenie dhe kontakte te rregullta. Qellimi eshte qe koleget tane te njihen me pervojen tone per nje problem qe na shqetson te gjitheve e qe eshte prezent ne te gjithe vendet tona dhe, te gjithe se bashku, te shikojme mundesite per t'u perfshire me gjeresisht ne kete ceshtje ne te ardhmen.

Duke perfituar nga sugjerimet dhe ndihma e personaliteteve te ftuara, vecanerisht nga koleget holandeze, dhe perfaqesuesit e ILO-IPEC, me te cilet kemi bashkepunuar ne menyre te efektshme dhe rezultative, dhe qe gjej rastin t'i falenderoj edhe nje here, duke degjuar edhe mendimet e propozimet e kolegeve nga Sindikatat e tjera te rajonit qe jane te pranishme, mendojme se, per te ardhmen, ne do te arrijme te ndertojme nje program efektiv pune, qe do te garantoje vijimesine e angazhimit tone ne frontin e perbashket per mbrojtjen e femijeve dhe eliminimin e punes se tyre.

# Kronike nga punimet e Konferences

Vijon nga faqja 3

Konferences moren pjese perfaqesues te sindikatave te arsimit nga Bullgaria, Rumania, Maqedonia, Serbia, Mali i Zi, Kosova dhe Moldavia.

Ne Konference moren pjese, gjithashtu, perfaqesues nga Presidenca, Ministria e Drejtesise, dhe anetare te tjere te Komitetit Kombetar per Mbrojtjen e Femijeve, Drejtore te Drejtorive Arsimore Rajonale, si dhe titullare te sindikatave te profesioneve nga dy grupimet kryesore sindikale ne Shqiperi, si ndertimi, bujqesia, shendetsia, perfaqesues nga institucionet e huaja qe punojne ne Tirane dhe qe jane te angazhuar per mbrojtjen e femijeve etj.

Shkembimi i informacionit dhe zgjerimi i aktiviteteve mbi eliminimin e punes se femijeve, fuqizimi i kapaciteteve te sindikatave te arsimit per te sjelle risi ne programet dhe veprimet per zhdukjen e ketij fenomeni, zgjerimi i perfshirjes se aktoreve te ndryshem dhe bashkerendimi i aktiviteteve ne nivel nacional e rajonal, me synim rritjen e ndergjegjesimit mbi çeshtjet e punes se femijeve, ishin disa nga synimet kryesore te kesaj Konference.

Z. Xhafer Dobrushi, Kryetar i Federates se Sindikatave te Arsimit dhe Shkences, mbajti ne emer te te dy sindikatave te arsimit, fjalen hyrese me teme "Sindikatat shqiptare te arsimit kunder punes se femijeve", ku i beri nje analize punes se deritanishme, evidentoi disa nga arritjet e problemet dhe e vuri theksin tek nevoja per nje nje angazhim me intesiv, jo vetem te sindikatave te arsimit, por edhe te atyre te degeve te tjera, jo vetem ne Shqiperi, por edhe ne vendet e tjera te rajonit.

Duke marre fjalen ne Konference, Ministri i Arsimit dhe Shkences, Z. Genc Pollo, theksoi:

Per mua, si Minister i Arsimit dhe Shkences, eshte hera e pare qe marr pjese ne nje aktivitet te sindikatave te arsimit ne nivel qendror, me te cilat kemi patur nje vit bashkepunim te frytshem, por gjithsesi ndonjehere i shoqeruar edhe me tensione. Tanime eshte e qarte se sindikatat e arsimit nuk jane ne gjendjen qe ishin ne shekullin e kaluar, qe mendonin vetem per paga apo greva. Ne kete fillim shekulli, ato, si perfaqesuese te mesuesve, merren me ceshtje reale te reformimit te arsimit, perfshire edhe barazine e ofrimit te sherbimit arsimor per te gjithe, sidomos per ata nxenes qe vijne nga shtresat me ne nevoje dhe me te dobeta. Natyrisht, behet fjale per rritjen e cilesise se ketij sherbimi qe ofrojne shkollat tona. Prandaj jam i gezuar qe ju bashke me partneret tuaj sindikale nga Holanda, me pranine e ILO-IPEC, si dhe te kolegeve nga rajoni, organizoni kete tubim ne Tirane. Deshiroj qe miqve qe kane ardhur nga vendet e tjera t'u uroj mireseardhjen dhe qendrim te kendshem ne vendin tone.

Tema qe ju keni prekur dhe qe do te diskutoni ne kete konference dy ditore, eshte vertete e rendesishme, sepse ajo lidhet me nje shqetsim te madh mbare shoqeror, sic eshte puna e femijeve. Para disa ditesh, ne pergjigje te raportit te Sekretarit te Pergjithshem te OKB mbi punen e femijeve, debatuam me koleget ministra dhe UNICEF, per dhunen qe ushtrohet mbi femijet dhe

Vijon në faqen 8

Vijon nga faqja 7

mbi masat per ta eliminuar kete fenomen, duke bashkepunuar me shume aktore qe jane te interesuar dhe qe perfshihen ne kete front.

Tema e sotme eshte e nderlidhur me dhunen ndaj femijeve, sepse puna qe bejne te miturit dhe femijet nuk eshte nje veprim vullnetar dhe i ligjshem i tyre, por perkundrazi, ata perfshihen ne kete veprimtari te shtyre nga shkaqe ekonomike, sociale e psikologjike, te shtyre nga prinder apo tutore, ne kundershtim me ligjet e shtetit tone dhe konventat nderkombetare ku Shqiperia eshte pale. Analiza qe u paraqit ketu nga drejtuesit e sindikatave ishte nje trajtim i hollsishem i ketyre problemeve, qe ne i hasim cdo dite si ne Tirane dhe jashte saj. Prandaj eshte e nevojshme qe Qeveria dhe gjithe aktoret e tjere ta njohin kete situate te pakenaqshme, por edhe te ndermarrim se bashku nje aksion konkret, te planifikuar mire dhe afat gjate, ne menyre qe t'i japim pergjigjen e duhur dhe ta reduktojme punen e femijeve.

Eshte e nevojshme qe te reagojme te gjithe se bashku. Natyrisht qe shkollat tona jane te gatshme qe t'i mirepresin dhe te bejne nje trajtim special per ta dhe gradualisht, hap pas hapi, te ndermarrim fushata dhe aksione te vazhdueshme se bashku me Ministrine e Punes dhe Ceshtjeve Sociale, me Ministrine e Brendshme, me partneret sociale dhe me komunitetin. Ne si MASH kemi synuar qe ketyre nxenesve, te cilet marrin pjese ne shkollat tona, t'u ofrojme tema sqaruese dhe ndergjegjsuese per parandalimin e punes se femijeve, se kjo eshte pjese e kurrikules zyrtare, perfshihet ne lende si edukata, gjeografia, historia, sociologjia, etj. Kemi hartuar module tematike per mesuesit, per trajnimin e tyre lidhur me punen e te miturve, migrimin e brendshem, te drejtat e femijeve, shfrytezimin e tyre, formimin e aftesive per t'u mbrojtur nga shfrytezimi dhe dhuna e ushtruar ndaj tyre. Jane trajtuar dhjetra mesues ne te gjithe vendin, punohet per projektin shansi i dyte, per ata femije qe kane qene njehere ne shkolle dhe jane larguar, per arsye sociale, familjare etj, dhe tani e kane te pamundur te ulen ne bankat e shkolles, t'u jepet nje mundesi tjeter qe, me nje program te vecante, te mund te riintegrohen ne sistemin arsimor dhe te mund te mbarojne te pakten arsimin baze.

Tani eshte futur edhe sherbimi psikologjik ne shkolla, qe mundeson per te kaluar momentet e veshtira te natyres psikologjike te nxenesve, por sidomos per femijet ne nevoja te vecanta ky sherbim eshte edhe me i domosdoshem.

Lende te tjera, deri tani te nenvleftesuara, si muzika, sporti, artet etj, do te jene me mire ne vemendje te shkollave tona, te shoqeruara keto me aktivitete jashte programore, si festivalet, kampionatet, konkurset, qe i bejne shkollat me terheqese per femijet, por qe japin dhe nje formim shtese, qe mesimi ne klase sipas kurrikes nuk e jep. Duke i angazhuar ne aktivitete te tilla ne ndihmojme ne eliminimin e shfaqjeve si braktisja e shkolles, puna ne rruge, lypja, perdorimi i drogave te lehta, etj.

Prandaj mendoj qe angazhimi i gjithe partnereve dhe i sindikatave, te cilat tani kane nje organizim qe eshte efektiv per kete qellim eshte shume i nevojshem dhe ne si MASH do te jemi edhe me tej te angazhuar qe te realizojme programet dhe objektivat qe i kemi vene vetes, ne bashkepunim me partneret tane sociale.

Ne emer te sindikatave holandeze, Keshilltari Politik i FNV Mondiaal, Zoti Leo Mesman theksoi:

Se pari do te doja t'u shprehja mirenjohjen dhe vleresimin tim kolegeve te FSASH dhe SPASH per organizimin dhe mbajtjen e kesaj konference unike rajonale mbi punen e femijeve. Ne jemi te gjithe te ndergjegjshem sa perpjekje duhen per te organizuar nje konference si kjo dhe per te krijuar te gjitha kushtet e nevojshme per nje takim te suksesshem dhe frytdhenes.

FNV eshte konfederata me e madhe e sindikatave ne Holande, qe perfaqesohet nga rreth 1.2 milion anetare ose afersisht 60 % e te gjithe punetoreve te organizuar ne sindikata.

Projekti i bashkepunimit ne rajonin e Europes qendrore dhe lindore eshte nje pjese e rregullt e programit te FNV Mondiaal, Departamentit special te FNV per bashkepunimet per projektet nderkombetare dhe formave te tjera te solidaritetit nderkombetar.

Nuk ka qene gjithmone keshtu: fillimisht, kur u themelua departamenti yne, 30 vjet me pare, ai perqendrohej vetem ne sindikatat e vende ne zhvillim.

Por pas vales se ndryshimeve demokratike ne Europen lindore, qe nga Renia e Murit te Berlinit ne vitin 1989, u shfaqen shume nevoja dhe mundesi per te bere kembime dhe bashkepunime. Prandaj ne filluam te financojme nje numer ne rritje projektesh ne vendet e ashtuquajtura ne tranzicion, me partnere dypalesh e shumepalesh, veçanerisht Federatat E Sindikatave Globale si IUF dhe ICEM, si dhe ICFTU.

FNV Mondiaal ka prioritet tre çeshtje ne programimin e projekteve te saj: njohjen e te drejtave sindikale, forcimin dhe rinovimin e sindikatave dhe pergjegjesine e perbashket sociale.

Lufta kunder punes se femijeve eshte pjese e prioritetit te dyte. AOB se bashku me organizatat e saj si motra zhvilluan dhe zbatuan nje sere projektesh bilaterale ne pothuajse te gjithe vendet ne Eurpen juglindore, duke perfshire ate ne Shqiperi, pjese e se cilit eshte edhe kjo konference.

Qellimi kryesor i te gjithe ketyre projekteve eshte forcimi dhe rinovimi i sindikatave, nga brenda por edhe nga jashte, sepse gjithandej ne shohim se sindikatat si partenere sociale sfidohen ashpersisht nga politikat neo liberale te qeverive dhe punedhenesve.

Sipas kendveshtrimit te FNV Mondiaal, forcimi dhe rinovimi i sindikatave eshte, gjithashtu, i lidhur ngushte me nje sere çeshtjesh specifike, konkretisht permiresimi i gjendjes se gave, organizimi i

punonjesve ne ekonomine informale, lufta kunder HIV/AIDS dhe lufta kunder te gjithe formave te punes se femijeve.

Keto sfida jane te nderlidhura me njera tjetren dhe te gjitha kontribuojne ne procesin e modernizimit te strukturave, kulturave dhe strategjive te sindikatave.

Lufta kunder te gjitha formave te punes se femijeve eshte nje nder shqetesimet kryesore te FNV Mondiaal. Ne jemi te lumtur ta ndajme kete shqetesim me nje grup te madh



institucionesh kombetare dhe nderkombetare si ILO, qeveri dhe OJQ.

Sipas kendveshtrimit tone, sindikatat kane arsye, pergjegjesi dhe mundesi te veçanta per te kontribuar per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve.

Çrrenjosja e punes se femijeve eshte pjese e nje detyre kryesore te sindikatave, qe ka te beje konkretisht edhe me perkrahja dhe mbrojtja e te drejtave te njeriut ne vendin e punes. Standardet me te pershtatshme te punes, te perfshira ne Konventat e ILO-s dhe qe duhet te zbatohen dhe te ruhen ne te gjithe boten jane: liria per t'u organizuar dhe per te negocuar ne menyre kolektive dhe te qenit i lire nga puna e detyruar, puna e femijeve dhe diskriminimi ne vendin e punes. Keto jane te drejta dhe liri te pavarura dhe perforcuese ne menyre reciproke.

Eshte e qarte qe sindikatat e arsimit kane interesat, pergjegjesite dhe mundesite e tyre te veçanta per te kontribuar ne luften kunder punes se femijeve.

Pra, per te diskutuar ne lidhje me kete jemi ketu sot dhe neser.

Per me shume se 10 vjet FNV Mondiaal ka mbeshtetur projekte kunder punes se femijeve me partnere sindikatat ne vendet ne zhvillim, veçanerisht ne Azi.

Sindikatat e arsimit ne Shqiperi, FSASH dhe SPASH, jane partneret tane te pare ne Europen Qendrore dhe Lindore qe kane treguar kurajo dhe bindje per te filluar sfiden e re te parandalimit dhe eliminimit te punes se femijeve dhe per ta bere ate nje pergjegjesi dhe detyre te mesuesve e sindikatave te tyre dhe per te kerkuar bashkepunim me investitore te pershtatshem. Prandaj ata meritojne lavderim dhe respektin tone per rolin e tyre inicues dhe rinovues. Shpresoj qe shkembimi i mendimeve dhe debatet gjate ketyre dy diteve do te frymezojne edhe sindikata te tjera arsimi per te ndjekur shembullin tuaj.

Puna kerkimore e shkelqyer e realizuar nga Samuel Grumiau dy vjet me pare me iniciativen e ICFTU dhe kontaktet dhe bashkepunimin frytdhenes midis sindikatave te arsimit te Shqiperise dhe kolegeve te tyre nga EI dhe AOB ka ndihmuar edhe per krijimin e kushteve te pershtatshme per kete projekt pilot.

Une permenda se sindikatat e arsimit duhet te luajne nje rol te veçante.

Por, sigurisht, edhe sindikatat ne sektore te tjere private dhe publike kane mundesi dhe shanse per te arritur rezultate ne parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve.

Projekte te suksesshme te sindikatave te punonjesve te ndertimit dhe tekstilit per shembull ne Indi e kane vertetuar kete.

Prandaj do te doja te perfundoja me urimin se kjo konference do te stimuloje sindikata te tjera te perfshihen ne detyren e rendesishme te sindikatave per te liruar femijet nga puna dhe per t'u dhene atyre akses ne arsimin qe ata kane nevoje dhe te cilin meritojne per nje te ardhme me te mire.

Po e mbyll fjalen time me nje citim nga nje pohim i Sindikatave ne Konferencen "Jashte Pune dhe Ne Shkolle" qe u zhvillua ne Hiderabad ne nentor 2004:

"Varferia nuk eshte shkaku i punes se femijeve; padrejtesia sociale eshte shkaku i punes se femijeve. Eshte puna e femijeve qe shkakton varferi; eshte nje nderprerje e zhvillimit. Ajo jo vetem qe demton femijen, por ajo demton edhe zhvillimin e vendit dhe te botes."

Zv/Drejtori i ILO-IPEC,
Zoti Geir Myrstad, pasi vleresoi organizimin e Konferences, ne fjalen e vete vuri ne dukje rendesine e bahkepunimit te frytshem midis sindikatave dhe ILO-IPEC ne Shqiperi. Strategjia jone eshte nje strategji e hapur per te gjithe, perfshire ne radhe te pare sindikatat e arsimit dhe te gjithe anetaret e tyre, te cilet duhet te jene aktive dhe te kualifikuar, sic jane mesuesit ne Shqiperi.

Po ne te njejten kohe, kjo eshte nje pune qe kerkon nje anagzhim te madh te te gjithe punonjesve. Sindikatat e

Vijon në faqen 10

Vijon nga faqja 9

arsimit qe punojne me shume ne kete fushe nuk duhen lene vetem. Ato kane nevoje per mbeshtetjen e te gjithe levizjes sindikale dhe te te gjithe aktoreve qe jane te angazhuar ne zbatimin e standardeve nderkombetare te punes dhe mbrojtjen e te drejtave njerezore e sindikale.

Ai theksoi, gjithashtu, se pervoja shqiptare eshte nje shembull i mire jo vetem per vendet e rajonit, por edhe per ato euopiane e me gjere dhe shprehu predispozicionin e ILO-IPEC per te vazhduar te punoje me sindikatat dhe partneret e tjere, si nje parakusht per arritjen e synimeve ne parandalimin dhe eliminimin progresiv te punes se femijeve.

Perfaqesuesja e EI,
Zonjusha Donatella Montaldo ne fjalen e vete theksoi:

Puna e femijeve aktualisht ka prekur mbi 218 milion femije ne shkalle boterore. Bujqesia, minierat dhe fabrikat jane vendet ku duket me shume puna e femijeve, por ka edhe forma te tjera te fshehura, sic jane punet ne shtepi, shfrytezimi seksual, skllaveria dhe trafikimi. Ne te njejten kohe mbi 100 milion femije ne shkalle boterore nuk e vazhdojne shkollen. Keto dy realitete jane te lidhura ne menyre te pazgjidheshme dhe ne nuk mund t'i neglizhojme ato.

Eliminimi i punes se femijeve eshte nje nga synimet kryesore te Federates Nderkombetare te Arsimit, EI, ne kontekstin e zbatimit te te drejtave njerezore dhe sindikale. Shume aktivitete mbrojtese per keto ceshtje jane organizuar nepermjet perpjekjeve te perbashketa te levizjes sindikale.

Aktualisht EI perfaqeson me shume se 29 milion mesues ne shkalle boterore, duke qene prezente ne 162 vende me me shume se 338 organizata anetare. Kjo siguron nje rrjet te rendesishem te aktoreve ne luften kunder punes se femijeve.

Federata Boterore e Arsimit, (EI), kontribuon ne luften kunder punes se femijeve ne dy menyra kryesore: Nepermjet levizjes sindikale dhe nepermjet Fushates Arsimim Per Te Gjithe. EI eshte pjese e levizjes sindikale dhe si e tille ka mundesi te pamasa te bashkoje anetaret e saj ne te gjithe boten ne nje force te vetme per nje çeshtje te veçante, siç eshte puna e femijeve. Veprime te tilla jane, gjithashtu, te afta te ndikojne pozitivisht mbi politikat e vendit.

EI eshte nje organizate qe perqendrohet ne arritjen e se drejtes se te gjitheve per arsim cilesor nepermjet sistemeve te arsimit qe financohen dhe administrohen publikisht, nje mjet vendimtar ne luften kunder punes se femijeve.

Federata Boterore e Arsimit trajton punen e femijeve ne kontekstin e iniciatives se Arsimimit Per Te Gjithe (EFA). EFA eshte nje angazhim boteror per te siguruar arsim themelor cilesor per te gjithe femijet, te rinjte dhe te rriturit. Qeverite, organet e Kombeve te Bashkuara, agjensite e zhvillimit, shoqeria civile, organizatat jo qeveritare dhe media jane partnere ne kete iniciative.

Per Federaten Boterore te Arsimit parandalimi eshte nje nga mjetet kryesore per te punuar kunder punes se femijeve. Te shkuarit ne shkolle eshte menyra me e mire per t'i mbajtur femijet larg punes. Kjo nuk do te thote vetem te permbushesh te drejten e tyre per arsimim. T'i mbash ata ne sistemin arsimor, ne periudha te gjata kohe, do te rezultoje ne te rritur qe do ta pajisin vendin ku ata banojne me burime njerezore me te mira dhe keshtu, do te rrisin zhvillimin social dhe ekonomik te vendit. Forcimi i politikave kombetare ne arsim dhe ne punen e femijeve nepermjet perkrahjes se arsimimit te detyruar, sipas parrulles "Arsimim Falas dhe Cilesor Per Te Gjithe" ka qene gjithmone dhe eshte akoma guri i themelit i sindikatave te mesuesve ne te gjithe boten. Ulja e numrit te femijeve qe braktisin shkollen per te shkuar ne pune, terheqja dhe mbajtja e femijeve qe punojne aktualisht, atyre qe kane punuar dhe femijeve ne rrezik per te punuar ne te ardhmen jane çeshtje ku mesuesit dhe sindikatat e mesuesve kane me shume mundesi te nderhyjne.

Edhe perfshirja e mesuesve ne monitorimin e punes se femijeve mund te ndikoje.

Mesuesit dhe organizatat e tyre jane ne nje pozicion kyç per te monitoruar punen e femijeve, sepse ata kane kontakte te perditshme me femijet qe punojne, ata qe kane punuar dhe femijet ne rrezik per te punuar. Normalisht ata kane nje akses te gjere me femijet dhe prinderit e tyre ne komunitet. Kjo i lejon ata te identifikojne me me lehtesi femijet qe punojne dhe qe nuk frekuentojne shkollen rregullisht apo fare, i cili eshte hapi i pare i nje programi monitorimi te punes se femijeve. Njohja e sektoreve apo formave te punes se femijeve ne komunitet, krijimi i komiteteve per punen e femijeve ne shkolla dhe informimi i prinderve, autoriteteve lokale dhe kombetare mbi kete çeshtje, jane hapat e tjera ne sistemin e monitorimit, ne te cilin mesuesit mund te kontribuojne ne menyre domethenese.

Seanca e dyte, te cilen e drejtoi me shume kompetence dhe aftesi, perfaqesuesi i FNV, Mario Luytgaarden, u hap me nje film te shkurter te pergatitur nga ILO-IPEC, ne lidhje me domosdoshmerine e angazhimit per eliminimin e punes se femijeve. Me pas, ne emer te sindikatave shqiptare te arsimit, Stavri Liko, paraqiti konkretisht punen e bere, eksperiencen e fituar dhe synimet e FSASH e SPASH gjate dy viteve te ardhshme.

Ne vijim, paraqiten prezantimet e veta perfaqesuesit e sindikatave te arsimit te rajonit, midis te cileve, Zonja Maria Kornelia Becic, perfaqesuese e FSLI, Rumani, Zonja Yanka Takeva, presidente e sindikates se arsimit te Bullgarise, SEB, Zonja Borka Visnic, ne emer te sinbodikatave te arsimit te Serbise, Zoti Dojcin Cvetanovski, President i sindikates se arsimit te Maqedonise, SONK, Zoti Viktor

Talmaci, perfaqesues i sindikates se Ndertimit te Moldavise, Zoti Xhafer Xhaferi, Zv/Kryetar i Sindikates se Arsimit te Kosoves, SBASHK.

Shume interesant ishte prezantimi i perfaqesuesit te Zyres Rajonale te ILO – IPEC, ne Bukuresht, zotit Patric Daru, i cili vuri ne dukje angazhimin rajonal te kesaj zyre, ne bashkepunim te ngushte me partneret vendas, duke perfshire edhe sindikatat dhe parashtroi disa nga synimet e ILO-IPEC gjate dy-tre viteve te ardhshem.

Me shume interes u ndoq nga pjesemarresit seanca e mbasdrekes, organizuar ne Bathore, me pjesemarrjen



edhe te perfaqesuesve te komunitetit te kesaj zone, perfshire mesues e drejtues te shkollave, prinder e nxenes, perfaqesues te pushtetit lokal etj.

Seanca ishte konceptuar ne formen e pyetje - pergjigjeve ne mardhenie me panelin kryesor, ku ishin te pranishem drejtuesit e kater grupeve te punes qe veprojne ne Bathore, Fier, Shkoder dhe Elbasan, si edhe perfaesuesi i prinderve, nxenesve dhe Shoqates "Bathorja, shtepia jone".

Ne diten e dyte u organizuan tre workshope, (seminare me pjesemarrje aktive ne diskutime), ne lidhje me tre ceshtje te rendesihme qe lidhen drejtperdrejte me punen e femijeve, si ajo e angazhimit te sindikatave te arsimit dhe perfshirjes se sindikatave te degeve te tjera ne parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve, drejtuar nga perfaqesuesi i FNV, Mario Luytgaarden, gjendja dhe nevojat per permiresime ne legjislacionin qe lidhet me punen e femijeve, drejtuar nga kryetari i FSASH-it, Zoti Xhafer Dobrushi, si edhe sistemi i monitorimit te punes se femijeve, drejtuar nga Menaxherja Kombetare e ILO-IPEC ne Tirana, zonja Snezhi Bedalli.

Ne te tre workshopet u bene diskutime konkrete me verejtje e propozime, konkluzionet e te cilave u paraqiten ne seancen plenare ne vazhdim dhe po reflektohen ne programin e veprimeve qe eshte ne perpunim, sidomos ne lidhje me objektivat dhe synimet kryesore te aktoreve te angazhuar ne problemin e mbrojtjes se femijeve dhe eliminimit te punes se tyre.

Ne seancen perfundimtare, zoti Leo Mesman vleresoi faktin qe sindikatat shqiptare te arsimit jane te anagzhuara dhe po merren konkretisht dhe me efektivitet me eliminimin e punes se femijeve. Rezultatet e arritura jane te dukeshme dhe, mbi kete baze, ato duhet te zgjerojne eksperiencen, jo vetem tek sindikatat e degeve te tjera ne Shqiperi, por edhe tek ato te vendeve te tjera te rajonit. Federata nderkombetare e Arsimit, EI ka nje rol te rendesishem koordinues per te luajtur ne kete drejtim.

Ide te reja u shprehen ne kete Konference dhe ne te gjithe shpresojme qe kjo konference do te jete fillimi i nje hapi tjeter pune konkrete, duke shpresuar, gjithashtu, qe sindikatat shqiptare te arsimit do t'i ndihmojne qe edhe sindikatat e degeve te tjera ne Shqiperi dhe ato te vendet e tjera te rajonit, do te ecin ne kete rruge dhe do te kene rezultate konkrete brenda pak viteve te ardhshme.

Perfaqesuesja e Federates nder-kombetare te Arsimit, EI, Zonjusha Donatela Montaldo, duke e konsideruar Konferencen nje fillim te mire, vleresoi faktin qe ketu jane mbledhur kaq shume sindikata dhe perfaqesues sindikale nga vendet e rajonit dhe po nxjerrin konkluzione te vlefshme per ato qe kane bere e sidomos per punen e tyre ne te ardhmen. Eshte e nevojshme, vijoi ajo, qe ne te kemi nje plan e strategji te qarte per ta trajtuar kete problem, duke filluar ndoshta me nje rrjet informimi dhe kembimi mendimesh qe eshte e nevojeshme te vendoset sa me pare midis sindikatave te vendeve te rajonit.

Duke bere konkluzionet ne emer te sindikatave shqiptare, zoti Xhafer Dobrushi, vuri ne dukje rendesine e faktit qe dy sindikatat shqiptare te arsimit punojne se bashku, si per shume ceshtje te tjera, edhe per angazhimin e mesuesve dhe te parnereve te tjere per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve. Kemi arritur rezultate modeste, theksoi ai, por kemi akoma shume probleme. Konferenca qe ne po mbyllim ka nje rendesi te vecante. Dje kur e filluam ne nuk e kishim te qarte vizionin dhe synimet ne gjeresi te tille, jo vetem ne rajon, por as ne vendin tone. Tani ne jemi me te vetedijshem ne lidhje me situaten, problemet, synimet dhe aktivitetet qe duhet te ndermarrim.

Ne perfituam, gjithashtu, nga sugjerimet dhe ndihma e partnereve tane te ftuar ne kete konference, sidomos nga kolegët e sindikatave holandeze dhe ILO-IPEC, me te cilet kemi bashkepunuar ne menyre efektive dhe jemi te angazhuar qe te vazhdojme te punojme se bashku.

Mbi kete baze, ne do te perpunojme nje program konkret me nje angazhim te perbashket ne frontin e perbashket te mbrojtjes se femijeve dhe eliminimit te punes se tyre.

Stavri Liko
Kordinator i Projektit

Cilesi dhe barazi ne arsim

# KONFERENCE PER PROGRAMIN VJETOR TE REFORMES

Ministria e Arsimit dhe Shkences organizoi me 25-26 tetor konferencen per programin vjetor te reformes "Cilesi dhe Barazi ne Arsim". Projekti eshte pergatitur nga Qeveria

Shqiptare ne bashkepunim me Banken Boterore dhe do te ndihmoje ne zbatimin e Strategjise Kombetare te Arsimit.

Objektivi kryesor i projektit eshte te permiresoje cilesine e kushteve te te nxenit per te gjithe nxenesit dhe studentet, te rrise frekuentimin ne arsimin e mesem te pergjithshem, ne vecanti per te varferit si dhe te garantoje vijueshmerine e reformave te koheve te fundit ne sektorin e arsimit.

Ne projektin "Cilesi dhe Barazi ne Arsim" po perdoret per here te pare nje qasje mbaresektoriale ne Shqiperi. Strategjia Kombetare e Arsimit perben bazen e ketij projekti dhe kesaj qasjeje dhe Qeveria do te organizoje takime gjashtemujore ne muajt maj e tetor (ne kuadrin e te cilit eshte organizuar edhe ky takim) te cdo viti per te paraqitur Programin e Reformes Vjetore dhe per te rishikuar ecurine e tij.

Parashikohet qe kjo qasje mbaresektoriale te forcoje pronesine e programit te reformave nga ana e qeverise, te lehtesoje bashkepunimin dhe koordinimin midis partnereve te zhvillimit dhe te forcoje kapacitetin manaxherial te sistemit arsimor.

Fushat prioritare te Projektit jane: fuqizimi i lidershipit, menaxhimi dhe qeverisja e sistemit arsimor, permiresimi i kushteve te mesimdhenies e te nxenit, permiresimi dhe racionalizimi i infrastruktures arsimore dhe pergatitja e terrenit per reformen ne arsimin e larte.

Ministri i Arsimit dhe Shkences, Z. Genc Pollo beri prezantimin e pergjithshem te Projektit, duke u fokusuar ne objektivat dhe prioritetet.

Sic theksoi Ministri, prioriteti i pare lidhet me forcimin e lidershipit dhe kapaciteteve manaxhuese si dhe forcimi i qeverisjes dhe pergjegjshmerise se sistemit arsimor, qe do te thote:

- Zbatim i kujdesshem i decentralizimit, qartesimi i ndarjes se pergjegjsive, funksioneve dhe detyrave midis dhe ndermjet niveleve te sistemit arsimor.

- Futja e sistemeve te menaxhimit te bazuar ne performance.

- Caktimi i roleve te reja per drejtoret e shkollave.

- Rritja e vendim-marrjes dhe menaxhimit te burimeve ne nivel shkolle,

- Rritja e pjesemarrjes se komunitetit.

- Shfrytezim i plote i Sistemit te Informacionit te Menaxhimit te Arsimit (EMIS) ne sherbim te vendimarrjes.

Prioriteti i dyte, synon permiresimin e mesimdhenies dhe nxenies, si nevoje per nje rishikim te pergjithshem dhe permiresime rrenjesore. Konkretisht:

-Reforma kurrikulare,

-Hartimi i nje programi sistematik dhe afatgjate per kualifikimin profesional te mesuesve dhe drejtoreve te shkollave,

-Reforme ne vleresimin e nxenesve,

-Forcimi i kapaciteteve te MASH, te Qendres Kombetare Arsimore te Vleresimit dhe Provimeve, Institutit te Kurrikules dhe Standardeve, Qendres se Trajnimit dhe Kualifikimit per Arsimin dhe Drejtorive Arsimore.

Prioriteti i trete, ka si objektiv permiresimin dhe racionalizimin e infrastruktures arsimore, vecanerisht ne arsimin e mesem. Ky prioritet perfshine:

-Investime me efektive dhe (ri)alokim ne infrastrukturen fizike dhe ne burimet njerezore.

-Marrjen e vendimeve ne fushen e investimeve bazuar ne hartat shkollore, duke marre parasysh levizjet demografike dhe migracionin.

-Laboratore shkencore dhe laboratore te informatikes per shkollat e mesme te pergjithshme,( qe do te shoqerohet edhe me trajnim te mesuesve).

Prioriteti i katert lidhet me pergatitjen e terrenit per reformen ne arsimin e larte, duke synuar vecanerisht:

-Modernizimin e struktures dhe kurrikules,

-Forcimin e strukturave qeverisese te universiteteve,

-Forcimin e mekanizmit te sigurimit te cilesise dhe akreditimit,

-Permiresimin e legjislacionit dhe formules se financimit,

-Rritjen e autonomise financiare dhe pergjegjshmerise se universiteteve,

-Mobilizimin e financimit privat,

-Permiresimin e efektivitetit te financimit publik,

-Vendosjen e urave lidhese midis kerkimit shkencor dhe mesimdhenies,

-Lidhjen me te qendrueshme me tregun e punes.

Per secilin prioritet u mbajten referate te vecanta ne diten e dyte te zhvillimit te Konferences dhe u bere diskutime ne grupet perkatese.

Z. Xhafer Dobrushi, kryetar i FSASH dhe z. Bajram Kruja, kryetar i SPASH, qe muaren pjese ne Konferencen plenare dhe ne punimet e grupeve te vecanta, theksuan rolin dhe angazhimin e sindikatave te arsimit, si partnere sociale, ne procesin e reformimit dhe modernizimit te arsimit. Drejtuesit e sindikatave kerkuan nga DAR dhe ZA qe te njihen me mire me Kontraten Kolektive te Punes, ne te cilen jane sanksionuar shume elemente te ketij procesi reformimi dhe te punohet me korrektesi nga te dy palet per t'i zbatuar ato.

Pas relatimit te konkluzioneve qe paraqiti cdo grup, per secilin prioritet ne seancen plenare, Ministri i Arsimit dhe Shkences z. Genc Pollo theksoi angazhimin e MASH dhe te strukturave te saj per realizimin e objektivave te Projektit "Cilesi dhe Barazi ne Arsim".

Korresp. i "Tribuna Sindikale"

# HOMAZH PER MESUESIN DHE QYTETARIN E NDERUAR



U nda nga jeta mesuesi dhe qytetari i nderuar Liman Pecanka. Limani lindi ne vitin 1949 ne nje familje gjakovare qe ishte vendour qe ne vitin 1924 fillimisht ne Krume te Hasit e me pastaj ne qytetin e Kukesit.

Limani mbaroi studimet e larta ne ish Institutin e Larte Pedagogjik te Shkodres, ne

degen histori, gjeografi, fiskulture ne vitin 1971, ndersa ne vitin 1975 plotesoi studimet e larta ne Universitetin e Tirares.

Vitet e para mbas mbarimit te shkolles se larte punoi ne Seksionin e Arsimit te rrethit, ndersa per 5 vjet me radhe eshte zgjedhur kryetar i Komitetit te Fizkultures dhe Sportit ne rrethin e Kukesit.

Me punen, kujdesin dhe aftesite e tij profesionale jane pergatitur shume ekipe sportive te rinjsh ne lloje te ndryshme sporti, jo vetem ne qytet, por edhe ne shkolla te zonave te thella si Arren, Shishtavec, Kalis, Bicaj, Shemri, ne Gryke te Cajes, etj.

Limani gjithe jeten ia kushtoi arsimimit te brezit te ri. Gjate 35 vjetve ne kete sektor, ai punoi edhe ne shkolla te fshatrave si ne Dukagjin, Bushat, Bardhok, etj.

Qytetaret e Kukesit e kane nderuar dhe respektuar gjithnje si edukatorin e dashur, kembengules dhe te ngrohte per femijte e tyre. Ne shkollat e qytetit ku ka punuar dhe vecanrisht ne Shkollen e Mesme te Pergjithshme " Havzi Nela" ai gezonte respekt te vecante nga koleget, nxenesit dhe prinderit.

Limani ishte nje mesues e qytetar i nderuar, por njekohesisht ishte dhe nje sindikalist i spikatur. Ai eshte trajnuar disa here ne Shkollen Sindikale te KSSH dhe ka kryer detyren e trajnuesit per Keshillin Sindikal te Qarkut te Kukesit. Per Veprimtarine e tij te vendosur ne mbrojtje te interesave dhe kerkesave te mesuesve, per qartesine ne orientimin e levizjes sindikale ne rreth, per angazhimin e palodhur per te ndihmuar shoket dhe keshillat sindikale, Limani eshte zgjedhur per vite me radhe ne stafin drejtues te Seksionit Sindikal te FSASH per rrethin e Kukesit.

Limani vdiq papritur nga infarkti i miokardit, duke dhene mesim para nxenesve te klases III-B te profilit te Pedagogjikes, por ai do te mbetet i paharruar per te gjithe ata qe e kane njohur.

Shoket e tij mesues nga i gjithe qyteti dhe zonat per rreth, nxenesit dhe gjithe qyteti i Kukesit i dhane lamtumiren e fundit ketij mesuesi dhe qytetari te nderuar, ketij sindikalisti te palodhur. Lulet e shumta mbi varrin e tij ishin deshmi e dhimbjes per humbjen e Limanit dhe premtim se ai do te kujtohet gjithmone si shembulli i mesuesit te perkushtuar dhe qytetarit te nderuar.

Zylfi Tola

Kryesia e Federates se Sindikatave te Arsimit dhe Shkences te Shqiperise, shpreh hidherimin e saj te thelle per humbjen e mesuesit e veprimtarit te dalluar sindikal Liman Pecanka dhe i shfaq familjes Pecanka ngushellimet per kete humbje te rende dhe te parakoheshme.

# TE PERKUSHTUAR E OPTIMISTE PER ARRITJE TE REJA

(Ne shkollen e mesme te pergjithshme "Jordan Misja"-Shkoder)

1.

Nje nga shkollat e mesme te njohura ne qytetin e Shkodres, eshte edhe ajo qe mban emrin e mesuesit deshmor Jordan Misja. Ne mbyllje te vitit te kaluar mesimor u shenua kalueshmeria 87.5 per qind dhe nota mesatare 6.3. Ne pese matura mbaruan 191 nxenesit e tyre dhe nga ata sivjet 158 vazhdojne shkollen e larte ne vend e 29 te tjere jashte shtetit. Kjo, sigurisht, nenkupton nivelin e larte te mesimdhenies e te mesimnxenesies.

Viti i ri mesimor ketu nisi me afer 1.000 nxenes e 50 mesues. Ne vitet e para jane 7 klase dhe ne mature 5 klase. Kur hyn ne mjediset e kesaj shkolle, gjen pasterti, rregull e perkushtim per plotesimin e detyrave nga çdo anetar i kolektivit mesues-nxenes. Ne ndihme te tyre jane rreshtuar edhe prinderit e tere komuniteti. Sivjet, per ta nisur sa me mbare punen mesimore edhe per ta çuar gjithnje perpara, u tregua kujdes per lyerjen e plote te mjediseve, meremetimet etj. Per kete gje dhane ndihmesen e tyre biznesmenet, si psh Viktor Kola dhe prinder e anetare te tjere te komunitetit.

Siç na tregon drejtori, Gasper Begu, por dhe zevendeset e tij, Vidushe Kurtabegu e Rozeta Hoxhaj, qysh ne fillim ketu po ngulmohet dhe po tregohet vemendje e perbashket e mesuesve, nxenesve e prinderve qe mos te krijohen zbrazeti ne procesin e pervetesimit te njohurive. Pozitive eshte se kuadri mesimdhenes eshte me

Vijon në faqen 13

# TE PERKUSHTUAR E OPTIMISTE PER ARRITJE TE REJA

Vijon nga faqja 13

arsimin dhe kualifikimin e duhur. Po keshtu, per mire ndikojne tekstet e siguruara dhe kabineti i i ri informatikes, me 17 kompjutera, dhurate e qeverise italiane. Ne tere veprimtarine e perditeshme ndodhet prane keshilli i prinderve, qe kryesohet nga Gjelosh Ibraj.

Per vitin arsimor ne vazhdim eshte percaktuar ky objektiv themelor: "Nxitja per rezultate te larta dhe edukimi i nxenesve si anetare tolerante, te kujdesshem dhe te




nder gjegjshem per shoqerine".

Per arritjen e synimeve te deshiruara, jane hartuar programe e plane pune te detajuara nga drejtoria, komisionet lendore dhe mesuesit e veçante.

Kujdes tregohet dhe per njohjen e pervetesimin e pervojes se perparuar, e cila eshte e pasur ne gjirin e vete kolektivit. Nder te tjera, ketij qellimi i ka sherbyer edhe njohja e arritjeve cilesore te mesuesve: Ylbere Troshani (kimi), Suela Serani (fizike), Rexhep Meta (anglisht), Drita Pema (edukate fizike), Ermira Ymeraj (letersi) e te tjere.

2.

Kur e viziton kete shkolle, te terheq vemendjen edhe biblioteka me mbi 2.000 tituj librash, e cila pasurohet ne vazhdimesi. Per kete gje kane ndihmuar donatore te ndryshem dhe bordi i shkolles. Por keshtu, veçanerisht e ndien gjallerine rinore ne palestren e shkolles. Ketu nder vite jane stervitur e pergatitur voleibolliste e basketbolliste cilesore, qe kane ushqyer skuadrat perfaqesuese te Shkodres.

Krahas mesimit, jane organizuar e do te zhvillohen edhe sivjet veprimtari te larmishme kulturore-artistike dhe fizkulturore-sportive. Nxenes te shumte e kane perfaqesuar kete shkolle ne veprimtari lokale e kombetare, si ne konkurse, olimpiada, spartakiada etj. Mesuesit e nxenesit jane krenare se Nard Teta i ka nderuar ata ne olimpiaden kombetare te kimise apo Lira Troshani, qe zuri vend te pare ne olimpiaden kombatare te fizikes dhe tani studion ne Amerike.

Shkruan per kete shkolle dhe kolektivin e saj mesues-nxenes dhe nuk mund te lesh pa permendur gazeten periodike me titullin "Aktualitet rinor". Ajo ka vitin e shtate qe eshte botuar dhe ne te nxenesit gjejne veteveten, shkruajne e lexojne per jeten mesimore dhe veprimtarite e ndryshme, per te rejat e shkences e teknikes, zhvillojne aftesite e prirjet e tyre, sidomos ne krijimtarine letrare. Atyre u ndodhet gjithnje prane sidomos mesuesja e letersise, Rudina Llazani.

3.

Kur pyet per jeten e mesuesve ne sindikaten e arsimit, te tregojne se ajo eshte bashkepunetore e drejtorise per arritjen e te gjitha objektivave ne procesin mesimor dhe ne veprimtari te ndryshme edukuese e argetuese. Anetaret e drejtorise shprehen: "Me ata kemi gjetur mirekuptim e mbeshtetje te madhe per te gjitha çeshtjet mesimore-edukative, pra i kemi partnere ne tere jeten e perditeshme". Keshtu, bashkerisht jane diskutuar e zgjidhur çeshtje te mesimit e te edukimit dhe te jetes se secilit sindikalist.

Ata kane marre pjese edhe ne gezimet e ngjarjet e ndryshme te secilit mesues dhe kjo gje e ka forcuar ndjenjen e kolektivitetit e te pergjegjesise se perbashket. Per shembull, te gjitheve u la mbresa te veçanta veprimtaria e perbashket, e zhvilluar ne shkolle e ne lokal, me rastin e daljes ne pension te mesuesve Jorgjeta Postoli e Ruzhdi Kadia. Fjalet e mira, qe u thane per koleget, ishin per ta nje kujtim i bukur dhe i pashlyer per tere jeten.Po keshtu, i paharruar ishte edhe ekskursioni i perbashket i organizuar ne Razem.

...Ditet rrjedhin dhe ne "ditarin" e mesuesve e nxenesve te shkolles se mesme te pergjithshme "Jordan Misja" te qytetit te Shkodres shenohen arritje te reja. Ata te gjithe jane te perkushtuar dhe optimiste se ne vitin e ri arsimor do te arrijne cilesi me te larte ne mesimdhenie e ne mesimnxenie dhe do te pergatisin e zhvillojne veprimtari me te shumta e me bukura, per edukimin dhe argatimin e çdo pjesetari te kolektivit.

Murat Gecaj

# Të reja shkencore

### PRINTERI ME I VOGEL NE BOTE

Nje kompani suedeze ka hedhur ne treg PrintBrush, printerin me te vogel ne bote dhe te vetmin printer qe nuk ka kufizime te formatit qe duhet perdorur. Ai ka gjatesine e nje



stilolapsi normal dhe gjeresine e nje celulari te koheve te fundit. Pesha e tij eshte rreth 350 gram. Ai eshte krijuar per t'iu pershtatur xhepit te kemishes. Materiali qe deshirojme te printojme hidhet ne kete pajisje duke perdorur Bluetoothin si lidhje midis tij dhe celularit, kompjuterit etj. PrintBrush punon duke levizur doren ne menyre te panderprere ne çfaredolloj letre pavaresisht nga forma, permasat apo trashesia. Kjo pajisje merr parasysh te gjithe faktoret kufizues te levizjes se dores duke perfshire rrotullimin dhe ndryshimet e menjehershme te shpejtesise. Rezultati eshte shume i ngjashem me printerat dixhitale.

### MODELI ME LUSPA

Modeli ne forme luspash peshku ne veshjen e re per tenista te firmes Nike, (e quajtur Macro React), i zgjedhur nga tenistja Maria Sharapova per turneun US Open te ketij viti, nuk eshte thjesht nje dizenjo. Kur ju djersisni, kapaket e vegjel te copes hapen ne forme rrethore per te bere te mundur daljen e nxehtesise dhe lageshtires ne menyre qe ju te qendroni te fresket dhe te thate.



Nje rrjetez cope e holle dhe e tendosur nuk lejon qe materiali prej poliestre i veshjes te ngjitet ne lekuren tuaj. Sharapova nuk eshte e vetmja modele. Edhe Roger Federer ka preferuar nje bluze Macro React te Nike ne turneun e Wimbledonit.

### ZBULUESI

Per vite te tera njerezit i jane drejtuar Zotit kur donin ndihme per te gjetur sendet personale, si çelesin, celularin, pultin, kur ato nuk vendosen ne vendin e caktuar. Tani ju mund te ngjisni



nje etikete qe leshon vale me frekuence radiofonike ne sendin qe humbni me shpesh. Kur nuk arrini ta gjeni, jepini komanden Zbuluesit dhe ai do t'ju drejtoje ne vendodhjen e sakte duke ju udhezuar nese duhet te shkoni majtas apo djathtas, te ecni perpara apo mbrapa. Kur i afrohet shume afer objektit etiketa qe keni ngjitur leshon nje tingull ndihmes. E vetmja gje qe Zbuluesi nuk mund te beje eshte te gjeje veten. Per kete duhet t'i drejtoheni perseri Zotit.

Çmimi i kesaj pajisje eshte 190$.

### DYSHEKU NE AJER

Nuk po ju genjejne syte, jo. Ajo shtrese e sheshte qe rri ne fluturim 16 inch mbi dysheme eshte ne fakt nje krevat dhe po rri i zhvendosur nga toka pa u mbeshtetur asgjekundi, megjithese i lidhur me nga nje fije te holle ne kater qoshet e tij. Krevati qe rri pezull eshte endrra me sy hapur e nje projektuesi holandez i cili thote qe u frymezua nga nje film. Sekreti i tij eshte vendosja e rregullt e nje sere magnetesh qe mund te mbajne nje peshe shume te madhe, te instaluar ne krevat dhe ne dyshemene poshte tij. Fushat magnetike supozohen qe jane teresisht te sigurta per perdoruesit e ketij dysheku, por



keshillohet qe te hiqni vathet para se te thithen nga magnetet.

Çmimi eshte po aq i pabesueshem sa edhe kjo shpikje e re, 1.5 milion dollare.

# Keshilla praktike

## DHJETE GJERA QE MBUSHIN MENDJEN PER TE GJETUR NJE PUNE

Doni te vazhdoni te kerkoni me muaj te tere per pune? Sigurisht qe jo. Njerezit jane gjithmone ne kerkim te menyres me frytdhenese dhe te dobishme per te gjetur nje pune te re. Keshillat e meposhtme, kur kien parasysh gjate procesit te kerkimit te punes dhe gjate intervistes, do t'ju shkurtojne shume kohen.

### 1. Hartoni rezymene sipas interesave tuaja

Mund te duket me e shpejte t'i lini çdo punemarresi mbi tavoline faqe te tera me informacione te pergjithshme, por kjo do t'ju kushtoje shume kohe ne te ardhmen. Stilojeni rezymene tuaj per secilin vend pune ne menyre qe te tregoje qarte se si eksperienca juaj pershtatet me kerkesat e punedhenesit. Sekreti eshte qe eksperiencen qe lidhet drejperdrejte me vendin e punes ku po aplikoni ta vendosni te paren ne liste.

### 2. Zgjeroni kerkimet tuaja

Nese u jeni pergjigjur lajmerimeve ne gazete dhe nuk keni pasur asnje reagim, postojeni rezymene tuaj edhe online, kerkoni site interneti ku ofrohet pune, flisni me njerez. Ne sa me shume menyra qe te kerkoni, aq me shume ka mundesi te lidheni me punedhenesit e duhur.

### 3. Mos kerkoni vetem

Miqte tuaj, familja, ish koleget, secili prej tyre kane nje rrjet me vete dhe nje shok i nje shoku mund te kete njohjet perfekte. Mos jini i turpshem, beni te mundur qe rrethi juaj shoqeror te dije se jeni ne kerkim te nje pune.

### 4. Gjeni nje kompani qe ju pershtatet

Kontrolloni site interneti punedhenesish dhe u kerkoni miqve tuaj si eshte te punosh ne kompanite e tyre. Punedhenesit kerkojne per kandidate qe do te ishin shume te pershtatshem dhe do te beheshin te sukesshem ne brendesi te kompanise.

### 5. Mos u dekurajoni

Ekspertet vleresojne se koha mesatare per kerkimin e nje pune eshte midis 3 dhe 10 muaj dhe kjo do te thote shume refuzime. Ju vazhdoni kerkimet tuaja. Puna e endrrave po ju pret.

### 6. Jini gjithmone i pergatitur

Ju nuk mund te jeni asnjehere shume i pergatitur per takimin e pare me nje punedhenes potencial. Para se te beni intervisten, vizitoni gjithmone sitin e internetit te kompanise. Zbuloni sa me shume te mundni per produktet e kompanise, drejtuesit, qellimin e kulturen dhe pergatisni pergjigje per pyetje te zakonshme qe behen ne intervista.

### 7. Jini i perpikte

Qofte nje interviste formale apo jo, shkoni gjithmone 10 minuta me pare. Mendoni edhe trafikun dhe kohen e keqe kur llogarisni oren.

### 8. Vishuni dhe silluni sipas rolit

Ne nje vend pune biznesi vishuni gjithmone me rroba te cilesise me te mire qe mund te perballoni. Nje kostum serioz eshte gjithmone i pershtatshem per intervista.

### 9. Degjoni me shume se sa flisni

Edhe nese jeni i nervozuar ne nje interviste, perpiquni te mos flisni shume. Duke mbajtur gojen te mbyllur, mund te mesoni informacione te vlefshme per kompanine dhe te evitoni te thoni diçka qe do te deshironit me vone te mos e kishit thene.

### 10. Beni pyetje me vend

Ne fund te nje interviste punedhenesi do te pyese doemos nese keni ndonje pyetje. Pergatisni nje liste pyetjesh qe tregojne se ju keni bere kerkime dhe se jeni interesuar per kompanine.

Përgatiti faqen Eriona Vangjeli

# Tribuna sindikale

